



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË
VENDIM

Nr 71 Datë 15.10.2007

PËR

PËR RISHIKIMIN E NORMATIVAVE TË KONSUMIT TË UJIT
NË BASHKI

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës, Drejtoria e Personelit Protokoll-Arkivës dhe Mbështetjes për "PËR RISHIKIMIN E NORMATIVAVE TË KONSUMIT TË UJIT NË BASHKI", bazuar në ligjin nr 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32 pika "dh", ligjin nr 8399 dt. 09.09.1998 "Për buxhetin lokal", Udhëzimin nr 2 dt. 17.01.2007 i M.F. "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2007", Udhëzimin nr 353 dt.19.03.2007 të Ministrisë së Brendshme "Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2007", si dhe V.K.B. nr. 2 dt. 02.02.2007 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2007", mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë ndryshimin e normativave të konsumit ujit në Bashki të detajuar si më poshtë :

Nr.	EMËRTIMI	Plan 2007	Fakti si	Ndryshime		Plani i rishikuar
		ne lek	9-Mujor	+	-	Ne lek
1	Bashkia Korçë	220000	233072	100000		320000
2	Rajoni nr.1	40000	8182		25000	15000
3	Rajoni nr.2	80000	48383		10000	70000
4	Rajoni nr.3	20000	6384		5000	15000
5	Merkato mishi	90000	86556	30000		120000
6	Tregu i fshatar	270000	141284		30000	240000
7	Çezma publike	100000	102400	70000		170000
8	Therrtore	30000	0		30000	0
9	Tregu i peshkut	50000	31198			50000
Totali		900000	657459	200000	100000	1000000

2. Efekti i rritjes së normativave të konsumit të ujit prej 200.000 lekë do të përballohet brenda fondit të planifikuar për konsumin e ujit në vlerën 100.000 lekë dhe vlera prej 100.000 lekë do të përballohet duke ulur zërin “udhëtim-dieta” në shpenzimet operative.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Personelit, Protokoll-Arkivës dhe Mbështetjes në Bashki.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare e Këshillit

Raimonda NASE
Raimonda NASE